

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË

Numri i rastit 721/12

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

(HYRJE)

Ky aktgjykim është i datës 08/12/2014

AKTGJYKIM NË EMËR TË POPULLIT

Në bazë të nenit 359 *et seq.* të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje KPPK) *ex vi* neni 541, par. 1, KPPK, Gjykata Themelore e Prishtinës në këtë rast ka një trup gjykues të përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Jorge Martins Ribeiro (Kryetari i trupit gjykues) dhe Manuel Soares, së bashku me gjyqtaren e Kosovës Aferdita Bytyqi, me David Hegarty të caktuar si zyrtar ligjor.

Ky rast penal është kundre të pandehurve H.S., Sh.B. dhe A.M., të akuzuar me një aktakuzë të ndryshuar (fillimisht PPS nr. 01/2012, të datës 14/02/2012), data 07/11/2013, nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës, PSRK, me anë të së cilës i akuzuari akuzohet për “se ata në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të tentim shantazhit, nga neni 268, paragrafi 2 në lidhje me nenet 23 dhe 20 të Kodit Penal të Kosovës (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, KPPK, aktualisht e dënueshme në nenin 28 par.2 në lidhje me nenin 341 par. 2 të Kodit Penal të Kosovës), akuzë e cila është adresuar menjëherë në një urdhër të datës 14/10/2013 (dhe është diskutuar përsëri gjatë dëgjimit fillestar të mbajtur më 3 dhjetor 2013), në të cilin është dëshmuar se në rast se faktet e paraqitura në aktakuzë dëshmohen, Gjykata duhet t’i adresoj gjithashtu edhe veprën penale të “incizimit të paautorizuar “ siç parashihet në nenin 171 të KPPK (aktualisht neni 205 i KPK)

për të vlerësuar se a është kryer një vepër e tillë penale apo jo dhe nëse janë plotësuar të gjitha kërkesat në procedurale në mënyrë që të shqyrtohen nga gjykata.

Pas mbajtjes së dëgjimit fillestar më 03/12/2013 dhe shqyrtimet gjyqësore të hapura për publikun më 17/01/2014, 25/02/2014, 26/03/2014, 15/04/2014, 15/04/2014/ 17/06/2014, 03/09/2014, 01/12/2014 dhe më 04/12/2014, paneli ka diskutuar dhe votuar më 05/12/2014.

Diskutimi dhe votimi është bërë në pajtim me dispozitat e parapara në nenin 365 dhe 470 *et seq.*, deri në nenin 473 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, tani e tuje KPPK.

Aktgjykimi është shpallur (do të shpallet) gojarisht më 8 dhjetor 2014, në pajtim me dispozitat e parapara në nenin 366 KPPK , në prezencën ,kryesisht të Prokurorit të PSRK Reshat Millaku, pala e dëmtuar, të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës, në bazë dispozitave të përmendura , së bashku me nenin 470 *et seq.* KPPK.

Gjithashtu më 8 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, shpall në publik në vijim:

(DISPOZITIVI)

AKTGJYKIM

Të akuzuarit janë

1- H.S., nofka “D.V.”, djali i M.S.dhe A.T., mashkull, lindur më x xxx xxx në xxxx, Komuna e xxxxx, banor i fshatit të xxxxx, Komuna e xxxx, të kombësisë shqiptare, shtetas i Kosovës dhe i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i martuar, biznesmen, me nr. të letërnjoftimit RKS 2030438437. I pandehuri është asistuar nga avokati mbrojtës B.B.(si avokat kryesues) dhe Xh.M.

2 - Sh.B., nofka “P.”, djali i N. B. dhe D. S. B., mashkull, lindur më x xxx xxx në fshatin xxx, Komuna xxx, banor i fshatit xxx, Komuna e xxxx, kombësia shqiptare, shtetas i Kosovës, i martuar, tregtar, numri i letërnjoftimit RKS 1002128795. I pandehuri është asistuar nga avokati mbrojtës B.M..

3- A.M., nofka "L.", vajza e I.M. dhe D. Av., femër, lindur më xx xxx xxxx në fshatin xxxxxxxxx , Komuna e xxxxxxxxx, banore e fshatit xxxxxxxxx, komuna e xxxxxxxxx, kombësia shqiptare, shtetase e Kosovës, e pamartuar, studente e fakultetit juridik, me numër të letërnjoftimit RKS 1172199549. I pandehuri është asistuar nga avokat mbrojtës A.B.

Dhe në bazë të neneve 362, par. 1, dhe 370, par. 3, KPPK:

I pandehuri H.S. shpallet i pafajshëm për akuzën se ai "*në bashkëkryerje ka kryer veprën penale të tentim shantazhit, nga neni 268, paragrafi 2 në lidhje me nenin 23 dhe 20 të Kodit Penal të Kosovës*", pasi që nuk është dëshmuar që i akuzuari ka kryer veprat për të cilat është akuzuar (neni 364, par. 1.1.3, KPPK), kryesisht nuk është përcaktuar se "*në mënyrë për t'i sjellë vetës (...) dobi pasurore , pasi që i dëmtuari F.P., nuk e ka pranuar kërkesën (...), për t'i shitur atij pesë hektar tokë në Pejë përkundër kërkesave që janë bërë , të pandehurit janë pajtuar që të detyrojnë palën e dëmtuar F. për të transferuar dy hektar sipërfaqe tokë të referuar përmes shantazhit, në atë mënyrë që i pandehuri Sh.B.ka siguruar një kamerë të pandehurës A., (...) sipas marrëveshjes në mes të dëmtuarit F. dhe të pandehurës A.M., ata kanë shkuar rreth mesditës në motelin "Motrat Binjake" (...) dhe përderisa kanë qenë në dhomë duke kryer marrëdhënie së bashku, i pandehuri e ka aktivizuar me teledirigjues kamerën e cila ka incizuar, pastaj (...) i pandehuri Sh.B., i cili më 11.01.2012 (...) ka kërkuar nga pala e dëmtuar F. për t'i transferuar atij dy hektar tokë në Pejë, duke pas parasysh që F.i ka refuzuar, ata pastaj ia kane treguar atij përmes telefonit incizimin që e pandehura A. e ka bërë në motelin e lartshënuar, duke e kërcënuar atë se nëse nuk e transferon tokën brenda 48 orësh, ata do ta publikojnë incizimin përmes YouTube (...). Përkundër kërcënimeve, pala e dëmtuar F.i ka refuzuar për me i transferuar 2 hektar tokë në emrin e tyre*".

Dhe

Të pandehurit Sh.B. dhe A.M. janë shpallur të pafajshëm për akuzën se ata "*në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të tentim shantazhit sipas nenit 268, paragrafi, 2 siç janë akuzuar në lidhje me nenin 23 dhe 20 të Kodit Penal të Kosovës*".

Dhe në vend të kësaj, me shumicë votash, të pandehurit Sh.B. dhe A.M. janë shpallur fajtor për akuzën se arta “*në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të tentim shantazhit nga neni 268, paragrafi 1, në lidhje me nenet 23 dhe 20 të Kodit Penal të Kosovës*”, vepra penale që është më e butë se sa ajo për të cilën janë akuzuar, e cila është e njëjta vepër penale e cila është e njëjta vepër, shantazh, pa rrethanat rënduese të parapara në paragrafin 2, kryesisht si anëtarë të “grupit” dhe prandaj të drejtat e mbrojtjes nuk janë dëmtuar me këtë vendim.

Ata janë shpallur fajtor në atë mënyrë pasi që është vërtetuar se ata kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar (neni 365, par. 1.1.1 deri në 1.1.3 dhe 1.1.6, KPPK), kryesisht është vërtetuar se: “*në mënyrë për të fituar dobi pasurore për etën tënde apo për tjetrin dobi pasurore të kundërligjshme (...), të pandehurit janë pajtuar që të detyrojnë të dëmtuarin F.in për të transferuar dy hektar tokë sipërfaqe për të referuar përmes shantazhit, në mënyrë që i pandehuri Sh.B.i ka dhënë numrin e telefonit të dëmtuarit F. 044/200-385, tani të pandehurës A.M., e cila në fillim i ka dërguar atij një mesazh elektronik (sms) dhe pastaj pas kontaktit me telefon n. mes të pandehurës dhe palës së dëmtuar F.it, për të shkuar në një motel për të kryer marrëdhënie seksuale dhe e pandehura A. do ta incizonte me kamerë atë pa dijeninë e atij me kamere. I pandehuri B.ka siguruar një kamerë të pandehurit A., e cila është aktivizuar me teledirigjues; më 07.01.2012 në bazë të marrëveshjes në mes të dëmtuarit F. dhe të pandehurës A.M., ata shkuan rreth mesditës në motelin “Motrat Binjake” afër udhëkryqit Prishtinë-Ferizaj-Lipjan dhe përderisa ta ishin n/ dhomë duke kryer marrëdhënie , i pandehuri me teledirigjues e ka aktivizuar kamerën e cila i ka incizuar, pastaj ia ka dhënë kamerën të pandehurit Sh.B., i cili më 11.01.2012 (...) ka shkuar në “Flur Café”, pronar i së cilës është F.P., që ndodhet para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; i pandehuri Sh. ka kërkuar nga i dëmtuari F. për t’i transferuar atij dy hektar toke sipërfaqe në Pejë, pasi që F.i ka refuzuar, «ai» pastaj i ka treguar atij përmes telefonit incizimin e bërë në motelin e caktuar , duke iu kërcënuar atij se nëse nuk e transferon tokën brenda 48 orësh, «ai» do ta publikon incizimin në YouTube në atë mënyrë e cila do ta dëmtonte nderin dhe autoritetin e «tij». Përkundër kërcënimeve , pala e dëmtuar F. ka refuzuar për t’i transferuar (...) dy hektar tokë në emër të «tij»”.*

Caktimi i dënimit:

Në bazë të neneve 268, par. 1, 20, par. 2, 38, 64, par. 1, 42, 43, par. 2, dhe 44 KPPK, i pandehuri B. dënohet me 1 vit dhe 6 muaj burgim. Ky burgim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk e kryen edhe ndonjë vepër tjetër penale për periudhën 2 vjeçare.

Në bazë të neneve 268, par. 1, 20, par. 2, 38, 64, par. 1, 42, 43, par. 2, dhe 44 KPPK, e pandehura A.M. dënohet me 6 muaj burgim. Ky burgim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk e kryen ndonjë vepër tjetër penale për periudhën 1 vjeçare.

Konfiskimi i objekteve: Nuk ka objekte të numëruara në aktakuzë të cilat i nënshtrohen konfiskimit.

Nuk ka kërkesë pronësore: sidoqoftë, pala e dëmtuar duhet të jetë në dijeni mbi mundësinë e paraqitjes së padisë civile (ndaras nga rastet në vazhdim e sipër, e cila është vendim i tij).

Shpenzimet e procedurës (siç parashihet në nenin 450 të KPPK) paguhen nga i pandehuri Sh.B. dhe A.M.. Në bazë të nenit 450, par. 2.6, shumat e caktuara prej 100 eurove për secilin prej të pandehurve të paraqitur ne paragrafin e mësipërm.

Gjykata nuk e sheh si të nevojshme, që të shpall sipas detyrës zyrtare këtë aktgjykim në media apo radio apo televizor, neni 365, par. 1.1.6, KPPK, për të mbrojtur vlerat e drejtësisë dhe interesin publik.

(PARAQITJA E BAZAVE)

ARSYETIMI

A) Trupi gjykues dhe kompetenca :

Nuk është ngritur asnjë kundërshtim nga palët në lidhje me përbërjen e trupit gjykues. Në bazë të nenit 472, par. 1, KPPK, paneli konsideron se gjykata është kompetente , në bazë të nenit 9, par. 1, i Ligjit mbi Gjykata (Ligji nr. 03/L-199) Gjykata Themelore do të jetë gjykata e instancës së parë në Republikën e Kosovës,

në këtë rast (paragrafi 2) Gjykata Themelore e Prishtinës ka juridiksionin territorial dhe në bazë të nenit 11, par. 1, të të njëjtit ligj, Gjykata Themelore është kompetente për të gjykuar të gjitha rastet në instancë të parë, përveçse nëse nuk parashihet ndryshe në ligj.

B) Historiku procedural:

B.1- Më 12 janar 012 PSRK ka iniciuar hetimet kundër të pandehurve H.S., Sh.B. dhe A.M., të cilat kanë çuar në aktakuzën kundër tyre më datën 12 shtator 2012. Më 7 nëntor 2013, pas një urdhri fillestar, para caktimit të dëgjimit fillestar, të datës 22 tetor 2013, PSRK ka paraqitur dhe ndryshuar (gabimet në shkrim të emrave dhe numrat dhe gabime tjera) aktakuzën kundër të pandehurve H.S., Sh.B.dhe A.M..

B.2- Në këtë aktakuzë PSRK e akuzon të pandehurin për faktet në vijim: “ Në mënyrë që të përfiton për vete apo tjetrin dobi pasurore të paligjshme, pasi që pala e dëmtuar F.P., nuk e ka pranuar kërkesën e të pandehurit H.S., për t’i shitur atij pesë hektar tokë në Pejë përkundër kërkesave të bëra, të pandehurit janë pajtuar që të detyrojnë të dëmtuarin F. për t’i transferuar dy hektar tokë te referuar përmes shantazhit, në atë mënyrë që i pandehuri Sh.B., i ka dhënë numrin e telefonit palës së dëmtuar F. 044/200-385, tani të pandehurës A.M.t, e cila në fillim i ka dërguar një SMS dhe pastaj pasj bisedave telefonike në mes të pandehurës dhe të dëmtuarit F., për të shkuar në një motel dhe për të kryer marrëdhënie seksuale dhe e pandehura A. do ta incizonte këtë me kamerë pa dijeninë e tij. I pandehuri Sh.B.i ka siguruar kamerën të pandehurës A., të cilën e ka aktivizuar me teledirigjues; më 07.01.2012, në bazë të marrëveshjes në mes të palës së dëmtuar F.it dhe të pandehurës A.M., ata kanë shkuar rreth mesditës në motelin “Motrat Binjake”, afër udhëkryqit Prishtinë-Ferizaj-Lipjan dhe përderisa ata ishin në dhomë duke kryer marrëdhënie, i pandehuri e ka aktivizuar me teledirigjues kamerën dhe ka incizuar, pastaj ia ka dhënë kamerën të pandehurit Sh.B., i cili më 11.01.2012 së bashku me një person të pidentifikuar, kanë shkuar në kafenenë “Flur” Café, pronar i së cilës është pala e dëmtuar F.P., e cila ndodhet para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; i pandehuri Sh. ka kërkuar nga pala e dëmtuar F.i që ti transferon atij dy hektar tokë në Pejë, pasi që F.i ka refuzuar, ata pastaj i kanë treguar atij

përmes telefonit incizimin të cilin e ka bërë e pandehura A. në motelin e lartshënuar, duke iu kërcënuar atij se nëse nuk e transferon tokën brenda 48 orësh, ata do ta publikojnë videon në YouTube, në të cilën mënyrë ata do ta dëmtonin nderin e tij dhe autoritetin. Përkundër këtyre kërcënimeve , i dëmtuari F. ka refuzuar që t'i transferon atyre këta dy hektar tokë në emrin e tyre ”.

B.3- Duke e marrë parasysh faktet e kopjuara si më lartë, PSRK i ka akuzuar të pandehurit për veprën penale të tentim shantazhit, 268, paragrafi 2 në lidhje me nenet 23 dhe 20 të Kodit Penal të Kosovës ” (- KPPK, aktualisht i paraparë në nenin 28 par. 2 në lidhje me nenin 341, par. 2, i Kodit Penal të Kosovës), nën pretendimin se ata kanë kryer në bashkëkryerje, neni 31 KPK. Në urdhrin e datës 22 tetor 2013 gjykata ka theksuar se në rast se vërtetohen faktet e tilla, ekzistimi apo mos ekzistimi i veprës penale “incizimi i paligjshëm “ , si në nenin 205, par. 1, KPK, duhet të adresohen.

B.4- Dëgjimi fillestar është mbajtur më 3 dhjetor 2013 në të cilin afati kohor prej 10 ditësh i është aprovuar palëve në mënyrë që t'i lejohet atyre paraqitja e ndonjë mocioni, kundërshtimi apo kërkesë.

B.5- E pandehura A.M., ka paraqitur më 11 dhjetor , një kërkesë për të hedhur poshtë aktakuzën dhe më 13 dhjetor 2013, të pandehurit H.S. dhe Sh.B.kanë paraqitur kërkesa tjera me të njëjtin qëllim, ndonëse arsyetimi për kërkesat e tilla nuk ishin të njëjta. PSRK nuk i është përgjigjur asnjërës prej kërkesave. Me anë të aktvendimeve të datave përkatësisht 17 dhjetorit 2013 (në kërkesën për të pandehurën A.M.) dhe më 9 janar 2014 (në lidhje me kërkesën e të pandehurve H.S. dhe Sh.B.) kërkesat janë refuzuar. Këto aktvendime janë ankimuar dhe më 4 shkurt 2014 Gjykata e Apelit e ka refuzuar ankesën dhe ka miratuar aktvendimet e kontestuara të instancës së parë.

B.6- Më 3 mars 2014, në bazë të nenit 256 KPPK dhe 31 të Kushtetutës së Kosovës, i pandehuri H.S. ka propozuar që të merren në pyetje 6 dëshmitarë si dëshmitarë të mbrojtjes(H.S., H.S.1, M.S., M.H., dhe I.K.), duke i shpjeguar rrethanat për të cilat ata do të dëshmonin dhe relevancën e tyre për lënën e gjykuar, dhe ka bashkuar dokumente në lidhje me një marrëveshje paraprake të blerjes së tokës më 2006, në mes ët tij dhe palës së dëmtuar F.P., dhe në lidhje me procedurat në vazhdim e sipër në lidhje me marrëveshjet e tilla. Gjatë gjykimit,

përkthimet në gjuhën angleze të këtyre dokumenteve i janë bashkangjitur shkresave të lëndës.

B.7- Siç është cekur më lartë, dëgjimi fillestar është mbajtur më 3/12/2013 dhe dëgjimet e shqyrtimeve gjyqësore, të hapur për publikun, janë mbajtur më 17/01/2014, 25/02/2014, 26/03/2014, 15/04/2014, 15/04/2014/ 17/06/2014, 03/09/2014, 01/12/2014 dhe më 04/12/2014. Trupi gjykues ka diskutuar dhe votuar më 05/12/2014.

C) Paraqitja e bazave në bazë të neneve 364, 365 dhe 370 KPPK:

C 1) – Faktet e dëshmuara të cilat janë relevante për vendimin:

C.1.1 – Më 11 shtator 2006, pala e dëmtuar F.P. dhe i pandehuri H.S. kanë hyrë në marrëveshje për blerjen e pasurisë së paluajtshme. Në bazë të dokumentacionit të shkresave të lëndës, kjo kishte të bënte me shitjen e 15 hektarëve tokë në Pejë dhe çmimi i pajtuar ishte 450000 euro. Në këtë kontratë shitësi i tokës ka qenë F.P. dhe blerësi ishte H.S., i cili e ka shfrytëzuar një *“njeri nga kashta”* si blerës, dhëndrin e tij M.H., emri i të cilit ishte i shkruar në kontratë si blerës dhe kontrata është përgatitur në zyrën e avokatit të cilin e ka zgjedhur shitësi, z. M.S., avokati nga Prishtina. Kontrata është nënshkruar më 11/09/2006.

C.1.2 – Ekzistojnë konteste në vazhdim e sipër në lidhje me kontratat e lartpërmendura:

C.1.2.1 – I pandehuri H.S., ndonëse padia civile është paraqitur nga dhëndri i tij M.H.(blerësi në perspektivën formale), pohon se 5 hektarë nuk i janë transferuar atij siç është dashur të bëhet, pasi që ata ishin nën hipotekë në atë kohë. Këta *“5 hektarë”* korrespondojnë me sipërfaqen prej 4,847 hektarë të cilat fillimisht janë përshkruar në departamentin e gjeodezisë si ngastra 4102/7 dhe më vonë është ndarë nga tani pala e dëmtuar në 96 parcela të reja, siç janë tani me numrat e regjistruar në zonën kadastrale në Pejë. Këto fakte janë përshkruar në padinë e paraqitur nga M.H.kundër tani të pandehurit F., të datës 30 maj 2012, para Gjykatës Komunale në Pejë. Paditësi kërkon nga gjykata që ta obligojë të paditurin (tani të dëmtuarin F.) për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale në atë mënyrë që në organin kompetent të nënshkruaj dokumentet e duhura për

bartjen e pronësisë nga emri i të paditurit në emrin e paditësit dhe nëse i padituri nuk vepron kështu, atëherë aktgjykimi do të zëvendësoj dokumentin dhe do të shfrytëzohet si bazë për ndryshime në zyrën kadastrale në Pejë duke e regjistruar të paditësin si pronar të pasurisë. Me anë të aktvendimit të datës 15/06/2012, me numrin referues 472/12, Gjykata Komunale e Pejës e ka aprovuar padinë për “masën e përkohshme të sigurisë për padinë, i padituri F. (B.) P. nga Prishtina e ka të ndaluar të tjetërsojë, vë nën hipotekë, jep me qira apo të ndërmer çfarëdo pune të ndërtimit në parcelat kadastrale në vijim (...) në total prej ” 4,847 hektarësh derisa të përfundon rasti civil duke u bazuar në merita, C.nr. 472/12.

C.1.2.2 – Më 30/09/2013, tani pala e dëmtuar F.P. ka paraqitur para Gjykatës Themelore në Pejë një padi civile kundër M.H.me anë të së cilës argumenton se ka hyrë në kontratë me të paditurin, kontrata e datës 01/06/2006, në të cilën ai ka shitur 15 hektarë tokë me çmimin prej 450000 Eurove dhe thotë se i padituri nuk i ka përmbushur detyrimet e tij, ky çmim korrespondon me 30000 Euro per hektar dhe ka paguar shumën totale prej vetëm 200000 Eurove, prandaj ai ka paguar sipërfaqen prej 6,6 hektarëve dhe 10 hektarë janë transferuar. Padit. Në mes tjerash, që i padituri së bashku me shokët e tij e kanë shantazhuar, kërcënuar dhe detyruar pa dëshirën e tij sa i përket posedimit të (...) sipërfaqes prej 10,15 hektarë (...) ata e kanë detyruar atë që të nënshkruaj dhe të vërteton kontratën e blerjes në Gjykatën Themelore në Pejë për shumën e parave prej 200000 Eurove. Kërkon nga gjykata që të merr një aktgjykim në të cilin i padituri obligohet që të kompensojë dëmin në shumën prej 334000 Eurove për sipërfaqen prej 3,34 hektarëve apo të anulohet pjesërisht kontrata e datës 11/09/2006 në mënyrë që t'i kthehet paditësit posedimi dhe përdorimi i parcelave që i korrespondojnë sipërfaqes prej 2,96 hektarëve dhe “41,46” hektarëve.

C.1.2.3 – Më 18/09/2013 në rastin 472/12 në Gjykatën Themelore në Pejë , është vërtetuar se ky rast penal është një “çështje preliminare” prandaj procedurat ligjore në rast janë ndërprerë për shkak të ekzistimit të një çështjeje preliminare dhe procedurat do të fillojnë pasi të merret një vendim në këtë rast penal. Palët kanë heqë dorë nga e drejta për ankesë.

C.1.3 – I pandehuri H.S. është daja i të pandehurit Sh.B. dhe ka huazuar para nga nipi i tij, i pandehuri M.H., për të hyrë në biznesin e blerjes së tokës në Pejë nga i dëmtuari F.. Shuma e parave e huazuar ndryshon nga 40000 eurove, në

bazë të pandehurit M.H., deri më 45000 apo 45500 eurove, në bazë të pandehurit S.. Marrëveshja ishte që i pandehuri B. në fund do të paguante jo me kesh por me një pjesë të tokës e cila i nënshtrohej marrëveshjes, në Pejë, pasi që ai i ka treguar dajës së tij se ka interes për tokë në Pejë, Tokën me të cilën ai do të paguante përbëhet prej “5” hektarëve dhe gjithashtu i nënshtrohen kontesteve civile pezull , kryesisht në rastin penal nga M.H.kundër të pandehurit F..

C.1.4 – I pandehuri B. ishte i vetëdijshëm për konteste në zhvillim në lidhje me tokën dhe në shtator apo tetor të 2011 ai ka provuar që të kontakton direkt me F.in, duke shkuar në kafenenë e tij, duke theksuar që të zgjidh problemin s ai përket atij, kryesisht për atë që ai e konsideronte si toke e cila duhej ti takonte atij, 2 hektarë, si një forme e pagesës për paratë të cilat i ka marrë hua. Pasi që nuk e ka takuar F.in, ai e ka pyetur njërin prej punëtorëve të tij për numrin e tij të telefonit dhe ka tentuar me kontaktuar disa herë për dy apo tre dite rresht; kjo tentative për ta kontaktuar ishte e pasuksesshme. Pasi që i pandehuri ishte i shqetësuar në lidhje me rimbursimin e tij , ai e kishte pyetur dajën e tij S. se si po shkonin punët, cilat ishin pritjet e zgjidhjes së kontesteve në zhvillim, pasi që ishte informuar nga daja i tij se do të ketë tentime tjera për të kontaktuar me F.in për të zgjidhur problemet, përndryshe një rast civil do të fillonte. I pandehuri B.ka pohuar se nëse paraqitet një padi civile , ajo do të merrte 2 deri në 3 vjet për të marrë një vendim përfundimtar, që i ka takuar atij.

C.1.5 – I pandehuri B. ka shkuar në ndërkohë dhe para Viti të Ri, me dijeninë e një personi të tretë, tek shoqja e tij e kamotshme A.M., tani gjithashtu e pandehur duke thënë se ishte i shqetësuar dhe se kishte probleme me tani të dëmtuarin F., ndaj së cilit ajo e ka pyetur se si mund ta ndihmojë për ta zgjidhur këtë problem, dhe pastaj ai i ka propozuar për të vepruar kështu, duke kërkuar nga ajo që të shkoj me të dëmtuarin F. dhe për të fjetur me të, me incizuar, në mënyrë që me shfrytëzuar incizimin kundër të dëmtuarit F.. Pasi që ajo ka refuzuar në fillim dhe pas insistimit të pandehurit M.H., ajo u pajtua më në fund , për të marr pjesë në planin e organizuar nga i pandehuri M.H., pasi që i pandehuri B.i ka premtuar asaj kompensim, me një ofertë për një vend pune.

C.1.6 - I pandehuri Sh.B.dhe A.M., së bashku me një person të pa identifikuar të tretë , janë pajtuar që të detyrojnë të dëmtuarin F. për t'i transferuar dy hektarë tokë në Pejë ne emër të Sh. M.H.t përmes shantazhit.

C.1.7 – Në ekzekutimin e planit, i pandehuri Sh.B., i ka dhënë numrin e të dëmtuarit F. 044/200-385, të pandehurës A.M. – i cili ka pasur në fillim një SMS dhe më pas, pas kontakteve të telefonit në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit F.P. –për të shkuar në një motel dhe për të kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarin; e pandehura A. pastaj pa dijeninë e tij do të incizonte aktin me kamerë.

C.1.8 –I pandehuri Sh.B. ka shkuar në shkup për të blerë kamerë, kamerën të cilën ia ka dhënë të pandehurës A., e cila është aktivizuar me teledirigjues. Më 07.01.2012, në bazë të marrëveshjes në mes të dëmtuarit F. dhe të pandehurës A.M., ata shkuan në mesditë në motelin “Motrat Binjake” afër rrugës Prishtinë-Ferizaj-Lipjan.

C.1.9 – Gjatë kohës kur ata ishin në dhomë të motelin duke kryer marrëdhënie në shtrat, e pandehura A.M., të cilën pala e dëmtuar në atë kohë e njihnte me emrin “D.”, e ka aktivizuar me teledirigjues kamerën e cila i ka incizuar ata, pastaj ia ka dhënë kamerën të pandehurit Sh.B., i cili e ka kopjuar incizimin në telefon mobil.

C.1.10 - Sh.B.më 11.01.2012, ka shkuar në kafenenë “Flur” Café, pronar i së cilës ishte pala e dëmtuar F.P., e cila ndodhet para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. I pandehuri Sh.B.ka kërkuar nga pala e dëmtuar F.i për t’i transferuar atij 2 hektar tokë në Pejë.

C.1.11 – Duke e marrë parasysh që F.P. ka refuzuar, i pandehuri Sh.B.më pas i ka treguar atij në telefon incizimin e lartpërmendur, të cilën e kishte bërë e pandehura A.M. në motelin e përmendur, derisa ata ishin në shtrat. Në incizimin që i është treguar palës së dëmtuar, vetëm pjesa e sipërme e shpinës së palës së dëmtuar ishte e dukshme pasi që pjesa e poshtë e trupit ishte e mbuluar me batanije apo çarçafë.

C.1.12 – I pandehuri Sh.B.e ka kërcënuar palën e dëmtuar F.P. se po qe se ai nuk e transferon tokën brenda 48 orësh, ai do ta publikonte incizimin përmes YouTube.

C.1.13 – Përkundër kërcënimit, pala e dëmtuar F.P. ka refuzuar për t’i transferuar dy hektarë tokë.

C.1.14 - Kërcënimet nuk janë përsëritur.

C.1.15 – Në kohën e akteve të lartpërmendura, të pandehurit ishin në gjendje për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tyre, të cilat ata i kanë dëshiruar.

C.1.16 – I pandehuri Sh.B.dhe e pandehura A.M. ishin shokë për vite të tëra dhe kishin punuar së bashku, në blerjen dhe shitjen e qeramikës.

C.1.17 – I pandehuri H.S. është i pasur, ka në pronësi pasuri të paluajtshme së paku në Kosovë. Është imigrant, biznesmen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai është i martuar, baba i 6 fëmijëve dhe ka studiuar në shkollën e letërsisë.

C.1.18 – I pandehuri Sh.B.është i martuar, baba i 4 fëmijëve, ai është tregtar, pronar i një Kafeneje dhe ka nivelin e shkollës së ekonomisë në Universitet, nuk e ka përfunduar. Ai e mban shtëpinë prej 6 anëtarësh.

C.1.19 – E pandehura A.M. është; e pamartuar, nuk ka fëmijë dhe studime në fakultetin juridik në Prishtinë.

C.1.20 – Të pandehurit ka një dosje të pastër.

C.1.21 – Në seanca të gjykatës i pandehuri B. përderisa është ulur në karrigen e të pandehurit i ka kërkuar falje të gjithëve, duke përfshire palën e dëmtuar dhe ka pranuar faktet kryesore.

Arsyetimi

Arsyetimi nuk është menduar që të jetë një përsëritje e provave materiale, funksioni i tij për të mundësuar shpjegimin e vendimin në lidhje me vërtetimin e fakteve apo jo.

Ekzistimi i kontratës është përcaktuar nga të dytë pala e dëmtuar dhe i pandehuri S., së bashku me dëshmitarët e propozuar nga i pandehuri S. të cilët kanë dëshmuar mbi këtë, kryesisht dhëndri M.H. dhe avokati nga Prishtina të cilët janë përzgjedhur nga pala e dëmtuar dhe në zyrën e të cilëve kontrata është përgatitur nga M.S.. Gjithashtu i pandehuri B. ka dhënë deklarata në lidhje m kontratën. Versionet janë të ndryshme dhe të dyja palët kanë paraqitë mospërputhje në versionet e tyre. Përveç kësaj shkresat e lëndës përmbajnë dokumente të cilat

kanë lidhje me kontratën dhe raste civile pezull dhe dëshmitar e propozuar nga i pandehuri kanë lejuar nga gjykata që të përcaktohet ekzistimi i tij.

Sa i përket kësaj çështjeje, do të bëhen disa vërejtje. Në lidhje me kontratën e shitblerjes së tokës në mes të palës së dëmtuar dhe të pandehurit S., dhe ndonëse dokumentet janë bashkangjitur (nga i pandehuri S. dhe nga PSRK, më 27/02/2014, tab 23 – pranuar sipas nenit 244, par. 3, KPPK) dhe dëshmitaret janë ekzaminuar, gjykata nuk ka dashur të përcaktojë kushtet e sakta të kontratës-dhe gjykata në këtë aspekt thekson se ekziston një rast civil pezull në Gjykatën Themelore në Pejë dhe ky gjykim nuk duhet të përdoret apo të shërbehet për të prodhuar prova kolaterale për këtë rast, ndonëse ky është konsideruar si “çështje preliminare”. Vlen të përmendet se sa i përket kësaj gjykata nuk ka kërkuar në mënyrë pro aktive për të përcaktuar detajet e marrëdhënies biznesore në mes të palës së dëmtuar dhe të pandehurit H.S. pasi që nga aspekti penal është jo relevante, pasi që kryerja e veprës penale apo tentativa për ta kryer atë, nuk mund të arsyetohet me anë të shkeljes së një kontrate apo performance në mes të palëve në kontratë.

Është me rëndësi për me vërejtur se i pandehuri S., siç do të shohim më poshtë, e mohon kryerjen e veprës penale, e cila e bën edhe më të tepërt “rëndësinë” e kontratës. Në lidhje me faktin që blerësi i vërtetë ishte S., asnjë provë logjike nuk është paraqitur s ai përket arsyes se përse në kontratë është nënshkruar emri i M.H., pasi që nëse je në SHBA kjo nuk është arsye për të penguar përgatitjen paraprake, para se me shkuar, të një autorizimi, në rast se nevojitet, e të mos përmendim se në rastin në vazhdim e sipër në gjykatën e Pejës, i pandehuri ia jep të drejtën vetës si “bashkëpronar”, ndonëse paditësi është pronari zyrtar-dëshmitari M.H.ka konfirmuar se është dhëndri i H.S.dhe se H.S. kishte qenë ai i cili ka qenë i përfshirë në negociata dhe blerje të tokës.

Është e rëndësishme gjithashtu , sic është theksuar më herët që të merrte një qëndrim i qartë në lidhje me çështjet civile, pasi që ky rast nuk mund të përdoret për të “prodhuar prova” në lidhje me rastet civile. Sa i përket kësaj, shumë gjëra mund të tregohen, megjithatë, ky është një rast penal për shantazh e jo një çështje preliminare , ashtu të themi, të rastit civil, pasi që ka kërkesa të ndryshme nga palët civile ,e mos të përmendim se shantazhi apo detyrimi që diskutohet këtu ka të bëjë me vitet 2012, e jo 2006 kur është përgatitë kontrata origjinale në zyrën e avokatit të F.it.

Përgjimi dhe regjistrime i thirrjeve telefonike siç është paraqite në aktakuze (të cilat janë prova të pranueshme) mund të përdoren për të vendimin e gjykatës në lidhje me faktet, pasi që ka pasur një përputhje në mes të përmbajtjes së këtyre komunikimeve dhe realitetit të tyre, ngjarjeve, të cilat marrin pjesë , të cilat janë konfirmuar nga mjetet tjera dhe përfundimisht të dyshuarit janë njohur nga pala e dëmtuar siç janë njohur edhe të pandehurit B.dhe A..

Tekst mesazhet që janë shkëmbyer në mes të pandehurve Sh.B.dhe A. (nga 15/12/2011 në 08/01/2012 dhe nga 10/01/2012 në 13/01/2012) janë shumë të qarta dhe janë konfirmuar nga ngjarjet të cilat kanë ndodhë, duke përfunduar me procesverbalin e takimit në motel dhe incizimin i cili i është treguar të dëmtuarit , ku ai e ka njohur vetveten. Përfshirja e personit të tretë rrjedh nga konteksti i sms kryesisht “ai ka premtuar se nuk ka lidhje nëse kjo ka sukses apo jo “ , data 13/01/2012, dhe nga bisedat telefonike të përgjuara , si ato në mes të Sh.B.t dhe një personi të panjohur më 12/01/2012 at 19.19.35h. dhe 22.13.21h. (në lidhje me polemikat e përcaktimit të përfshirjes së të pandehurit S. në komplot, të cilat rrjedhin nga përgjimet telefonike më 19.19.35 h., është me rëndësi për të përmendur se gjykata e gjen se nuk është e rëndësishme, pasi që nuk ka referim në lidhje me nipin në transkriptën në anglisht dhe referimi i tillë është përmendur vetëm në seancën gjyqësore të mbajtur më 04/12/2014).

Gjykata e sheh si të panevojshme për të përsëritur përmbajtjen e të gjitha provave të paparaqitura në aktakuze, në këtë aspekt. Këto janë prova ligjore të cilat gjykata i ka marrë parasysh.

Pala e dëmtuat e ka konfirmuar se i pandehuri B.ka shkuar atje për ta pyetur atë për t'ia transferuar (atij) 2 hektarë tokë dhe se është dhënë kushti prej 48 orësh dhe në lidhje me të pandehurën A.M. (ndonëse në atë kohë ajo i ka thënë atij se ajo quhet “D.”) ka konfirmuar faktet të cilat janë paraqitë në aktakuze dhe më lartë. E vetmja mospërputhje ka qenën fakti se sipas tij ishte një person i tretë në kafenenë e tij më 11/01/2012 kur B.ka shkuar atje. Gjithashtu ka konfirmuar se kontrata me të pandehurin S. e mban emrin e M.H.me kërkesën e H.S..

Pavarësisht, i pandehuri S. dhe B. kanë dëshmuar.

I pandehuri S. ka mohuar çfarëdo njohurie në lidhje me dijeninë apo përfshirjen në fakte të cilat janë të ndërlidhura me shantazhin, e ka prezantuar

versionin e tij të kontratës sa i përket tokës që e ka blerë nga i dëmtuari F. dhe i ka adresuar çështjet tjera të cilat nuk janë relevante për këtë fakt, pasi që ky rast është penal e jo civil siç ka qenë më herët. Gjithashtu është përmendur se e ka takuar të pandehurën A.M. për të parën herë në gjykatë, gjatë gjykimit.

I pandehuri B. i ka treguar detajet të cilat nuk ishin relevante gjithashtu. Në lidhje me faktet thelbësorë sa i përket shantazhit nuk i a pranuar ato, dhe se e ka organizuar planin për të shantazhuar dhe ka siguruar mjetet për bërë ate. Pohon se e ka humbur incizimin. Ka treguar pendim për atë që i është bërë të dëmtuarit. E ka tërheqë vëmendjen e gjykatës se është i vetmi i cili punon në shtëpi. Ka mohuar se ka shkuar në kafenenë Flur, se ka shkuar për të shantazhuar palën e dëmtuar me një person të tretë, dhe ka insistuar se ai ka shkuar në kafene vet.

Identifikimi i Sh.B.t dhe A.M.t nga pala e dëmtuar, përmes fotografive, është kryer ligjërisht.

Dëshmitaret kanë propozuar nga i pandehuri H.S. që kanë dhënë deklarata në lidhje me marrëveshjen për blerjen e tokës, siç është përmendur më herët.

Kërkesa e gjykatës për dosjet penale të pandehurit janë përgjigjur më 09/09/2014.

Të gjitha provat e prodhuara gjatë seancave janë regjistruar *verbatim*, prandaj edhe janë në dispozicion për ri-vlerësim, nëse është nevoja.

C 2) –Faktet të cilat nuk janë përcaktuar:

C.2.1 – Pasi që F.P. nuk ka pranuar kërkesën e të pandehurit H.S., për të shitur apo transferuar atij pesë hektarë tokë në Pejë, përkundër kërkesave të cilat janë bërë, i pandehuri H.S. është pajtuar me të pandehurit Sh.B. dhe A.M. për ta shantazhuar ate.

C.2.2- I pandehuri B. ka qenë së bashku me një person tjetër kur ka shkuar për t'ia treguar incizimin të dëmtuarit F.it në kafenenë Flur Café

C.2.3 – E njëjta gjendje ekonomike e të pandehurës A..

Arsyetimi :

Vetëm spekulime, supozime (kryesisht të bazuara në ekzistimin e bizneseve të mëhershme në mes të pandehurit H.S. dhe palës së dëmtuar, mbi faktin se i pandehuri Sh.B. është nipi i tij), përtej dyshimit të arsyeshëm, mund të qojnë drejt përcaktimit se i pandehuri H.S. ka qenë personi i tretë i përfshire; në lidhje me këtë është me rëndësi që të vlerësohet se ndonëse të pandehurit nuk e kanë ditur se biseda e tyre është duke u përgjuar përmes telefonit, emri i tij nuk është përmendur kurrë.

E pandehura A. e ka përdorë të drejtën e saj për të mbetur e heshtur prandaj disa aspekte të jetës së saj, kryesisht gjendja ekonomike, mbetet e panjohur.

Mungesa e sigurisë ë trupit gjykues në lidhje me çfarëdo fakti të dhënë, dmth dyshimi i arsyeshëm në lidhje me një fakt, i ashtuquajtur *non liquet*, duhet të veproj në favor të pandehurit. Gjithashtu, për t'i ikur konkluzioneve të gabueshme, gjykata e sqaron se mos përcaktimi i fakteve nuk do të thotë se vlen përcaktimi i faktit të kundërt apo realitetit. Prandaj, kur një fakt nuk përcaktohet kjo do të thotë vetëm se nuk ka qenë e mundur që të përcaktohet me anë të rregullave për vlerësimin e provave në procedurë penale, nuk do të thotë se nuk ka ndodhur fare.

D – Faktet dhe përgjegjësia penale e të akuzuarit (nenet 361 dhe 370, par. 7, KPPK):

Në bazë të nenit 370, par. 10, KPPK. “Kur i akuzuari lirohet nga akuza, në arsyetim veçanërisht shënohet arsyeja e paraparë në nenin 364 të këtij Kodi sipas së cilës ka vepruar “.

Nga tre situatat e parapara në nenin , i pandehuri H.S. në cilido rast do të lirohej nga akuzat pasi që “ nuk është dëshmuar se i akuzuari ka kryer verën për të cilën ai ose ajo është akuzuar” (neni 364, par. 1.3, KPPK). Është e qartë se përcaktimi i fakteve do të shpinte vetëm tek një konkluzion i tillë. Faktet të cilat mund të konsiderohen si përbërëse të veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri S. nuk janë dëshmuar. Kur faktet përbërëse nuk përcaktohen mund të ketë ndodhur për shkak të provave pozitive se i pandehuri nuk e ka kryer, faktet të cilat do të tregonin se kjo nuk do të përshinte përgjegjësinë penale apo vetëm sepse ato nuk janë përcaktuar, i cili do të ishte rasti në situatën aktuale, si njëri nga parimet bazik

në vlerësimin e provave, kur ekziston dyshimi kjo ende mund të konsiderohet si e arsyeshme (the *non liquet*), që është se vendimi në lidhje me provat dhe vlerësimi i tyre duhet të jetë në përfitim, favor të pandehurit , siç është treguar më lartë , cila shpie tek parimi kushtetues *in dubio pro reo*, neni 31, par. 5, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, “Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin” .

Në bazë të nenit 365, të pandehurit Sh.B.dhe A.M. do të adresohen më pas.

Përcaktimi i fakteve dhe përgjegjësia penale

Në këtë pjesë, përshkrimi i veprës penale për të cilën janë akuzuar të pandehurit do të adresohet fillimisht.

Vepra penale e shantazhit është paraparë në nenin 268, par. 2, i KPPK, aktualisht e dënueshme nën nenin 341, par. 2, KPK. Elementet e veprës penale në vetvete janë të njëjta në të dy versionet e Kodit, par.1, “Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, kanos personin tjetër se do të zbulojë diç në lidhje me të apo personat e afërm të tij që do të dëmtojë nderin apo autoritetin e tyre dhe në këtë mënyrë e detyron personin e tillë të kryej apo të mos kryejë ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tij apo të personit tjetër”.

Kjo vepër penale i mbron të drejtat juridike të lirisë, pasurisë dhe të drejtën në jetë private dhe intimitet, së bashku me vlerën e nderit (është një lloj specifik i detyrimit, e cila i mbron vetëm e drejta e lirisë dhe pasurisë) dhe mund të kryhet vetëm me qëllim , siç ndodh zakonisht me veprat penale (kryesisht) kundër pasurisë. Elementi subjektiv i përfshinë të dytë kryesin dhe një person tjetër pasi që përshkrimi penal i veprës parasheh “ për vetveten apo një person tjetër” dhe elementi normativ është qëllimi i përftimit të kundërligjshëm.

Sa i përket këtij elementi të fundit, shumë herë i adresuar në fjalën përmbyllëse , është me rendësi për të thënë se në këtë rast konkret varet nga kjo gjykatë për të përcaktuar rezultatet juridike të rasteve civile ë zhvillim , që do të thotë të kuptohet se transferi i përshkruar i tokës përbën apo jo përfitim të paligjshëm. Përveç kësaj, njëri mund të thotë se pa ndonjë kontakt të drejtpërdrejt në mes ët palës së dëmtuar dhe të pandehurit B.(e të mos përmendim të pandehurën A., i cili rast do të ishte edhe më i zhurmshëm) është një trimëri për tu përfshire në një polemikë të tillë. . . . Në përgjithësi ia vlen të përmendet se edhe

nëse ka situatë tjetër të përfshirë si në këtë moment ku përdoret kërcënim (në vend të mjeteve ligjore, kryesisht procedurave civile) për të zbatuar një “detyrim civil”, përsëri kemi shkelejt të vlerave të mbrojtura penalisht. Një kërcënim është jocompatibil me biznesin e kryer në mënyrë të ligjshme. Sidoqoftë dhe pasi që gjykata vlerëson se nuk ka nevojë për më shumë elaborim mbi këtë, njëri mund të pyet për arsyen se përse kemi palët (këtu civile) të cilat i kanë paraqitë rastet e tyre në gjykatë në Pejë, dhe atëherë përse ky kërcënim?- Gjykata pyet

Elementet përshkruese janë “ i kanoset personit tjetër se kundër tij do të zbulojë diç që do ta dëmtojë nderin apo reputacionin e tij/saj” si dhe ” dhe me këtë e detyron atë person të kryej ose të mos kryej ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tij/saj”.

Rrethanat rënduese që parashihen në par. 2 për të dyja versionet kanë ndryshuar me kodin e ri penal, me që rrethana “ose rezulton me dobi të madhe pasurore” është zëvendësuar me “ose vepra penale rezulton me dobi pasurore të kundërligjshme në shumën që tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro”. Elementi “anëtar grupi” përfshin definicionin “grup njerëzish” që aktualisht përcaktohet në nenin 120, par. 12, “3 apo më shumë persona”, kurse në versionin paraprak ky element nuk përshkruhet saktësisht në ligj, përkundër koncepteve tjera (madje edhe vetëm për një qëllim të dhënë), për shembull “ grupi i strukturuar” dhe “ grupi terrorist” (Neni 109, par. 4 respektivisht 5, i KPPK). Në këtë rast, megjithatë, do të ishte me rëndësi që të shtjellohet më shumë ky definicion, dhe pasojat e mundshme, vetëm nëse 3 të pandehurit ishin shpallur fajtor, pasi që interpretimi i ligjit të miratuar në ndërkohë do të ishte më i favorshëm.

Megjithatë, trupi gjykues i ka liruar të pandehurit nga ajo rrethanë rënduese, dhe për shumicën e trupit gjykues është i mundur dënimi sipas Nenit 1.

Të gjithë anëtarët e trupit gjykues pajtohen se të gjitha elementet e veprës penale të shantazhit, siç përcaktohet në nenin 268, par. 1, KPPK, janë plotësuar dhe se nuk është në kundërshtim me rregullat procedural apo të drejtat e mbrojtjes për ta vlerësuar përgjegjësinë penale për një vepër më të vogël penale, e të mos flasim për faktin se gjykata nuk detyrohet nga klasifikimi ligjor i fakteve të bërë nga Prokuroria.

Koncepti i grupit gjithmonë përfshin organizatën minimale , të strukturës dhe, në njëfarë mënyre, vazhdimin e saj në kohë. Përndryshe, do t'i dyfishonte konceptet bashkë-kryerje, ndihmë, nxitje etj., pasi që sa herë që 2 apo 3 apo më shumë persona do të merrnin pjesë në një veprë penale, atëherë ky do të ishte grup...

Duke marrë parasysh atë që posa u tha, tani është koha që të adresohet forma e kryerjes, bashkë-kryerjes:

Të pandehurit akuzohen se kanë vepruar në bashkë-kryerje. Duke marrë parasysh faktet e shtjelluara dhe përkufizimin e bashkë-kryerjes sipas nenit 23 (tani nenit 31) të KPK, “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprë penale”, të pandehurit Sh.B.dhe A.M. janë bashkëkryerës. Veprimet e të pandehurës A.M. shkojnë largë përtej konceptit ndihmëse, jo vetëm se ajo kishte marrë pjesë në faza të ndryshme të *iter criminis*, bashk me të pandehurin Sh.B., por gjithashtu sepse edhe “kontributi thelbësor: (siç përcaktohet në Nen) mjafton për ta dalluar ndihmën nga bashkë-kryerja, kjo duke marrë parasysh edhe konceptin e gjerë të ndihmës që përfshihet në nenin 25 (tani në nenin 33) KPK, sidomos kur vetë koncepti fton në interpretim të hapur duke përdorur fjalët “Ndihmë në kryerjen e një veprë penale përfshin, por nuk kufizohet vetëm në: (...)”.

Forma e veprës penale, tentativa:

Tentativa, sipas KPPK i ka kornizat e saj ligjore të përkufizuara në nenin 20, par. 1, KPPK, “Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë veprë penale” dhe tani përkufizohet në nenin 28 para. 1 KPK, “Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë veprë penale ”. Përkundër ndryshimeve të vogla në fjalët që i ka përdorur ligjvënësi përkufizimi mbetet i njëjtë. E njëjta gjë ndodh edhe me veprat Tentativa e papërshtatshme dhe Heqja dorë vullnetare (nenet 21 përkatësisht 22 KPPK., tani nenet 29 dhe 30 KPK).

Para se të shkojmë tutje në përcaktimin e sanksionet edhe një çështje meriton të përmendet. Me që gjykata nuk detyrohet nga klasifikimi i veprimeve (Neni 360, par. 2, KPK), disa referime i janë bërë veprës penale fotografimet dhe incizimet e paautorizuara siç përcaktohet në nenin 171 KPPK (tani në nenin 205 KPK, tani është koha që ta adresojmë atë. Në kohën e tanishme, faktet e vërtetuara do të ishin pjesë përbëheshin nga ajo vepër penale pasi që të gjitha elementet që tani shtrihen në përshkrimin aktual janë plotësuar. Tani vepra penale ndiqet *sipas detyrës zyrtare* por në atë kohë, sipas par. 3 të nenit të cekur “ Procedura penale për veprën penale nga ky nen inicohet sipas propozimit”. Prandaj, për këtë vepër penale nuk mund të konsiderohet se nuk ka pasur propozim me të cilin parashihej ndjekja e saj.

Në këtë rast po diskutojmë për tentativën, pasi rezultati i paraparë nga të pandehurit nuk është përmbushur, ata nuk kanë arritur ta detyrojnë viktimën ta kryej ndonjë veprim(në dëm të pasurisë së tij apo të fitojnë “dobi të paligjshme” në këtë rast).

Jo të gjitha tentativat janë të dënueshme, dhe ky është moment kur poshtë-nënshkruari, kryetari i trupit gjykues, nuk pajtohet me dy anëtarët tjerë Ky mendim mospajtues do të shpjegohet në votimin mospajtues që do t’i bashkëngjitet këtij aktgjykimi. Sipas dispozitës së nenit 471, par. 4, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nënshkruesi nuk e ka votuar dënimin, duke mos qenë i obliguar ta bëjë këtë, siç ruhet në procesverbalin e seancës së këshillimit dhe votimit.

Shumica e trupit gjykues është pajtuar se kjo tentativë është e dënueshme, pasi që janë plotësuar kërkesat e dënimit, sipas kuptimit, interpretimit të tyre të dispozitës së nenit 20, par. 2, të KPPK duke konsideruar se kështu është edhe interpretimi i dhënë nga Jurisprudenca e Kosovës, përkatësisht shprehja “ e dënueshme me së pakut tri vjet burgim” do të thotë, në mënyrën që është ekuivalente me” shprehjen në të cilën mund të shqiptohet dënimi me burg prej vjetësh”, kjo do të thotë se kjo tentativë do të jetë e dënueshme, madje edhe nëse shprehimisht nuk e jep ligji, duke qenë se ajo do të jetë gjithashtu e dënueshme çdo tentativë nëse dënimi maksimal me burg I paraparë për veprën penale është mbi tri vjet dhe, thënë shkurt, në këtë mënyrë, dënimi me burg prej tre vjetësh mund të shqiptohet.

Prandaj, dhe sipas këtij kuptimi:

Tentativa në këtë rast është e dënueshme sepse “Tentativa për kryerjen e një veprë penale të dënueshme me së paku tre vjet burgim, dënohet, kurse lidhur me veprat e tjera penale tentativa dënohet vetëm nëse ligji e parasheh shprehimisht këtë.” (Neni 20, par. 2, KPPK.).

Sipas nenit 20, par. 3, KPPK. Personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet më butë se sa kryerësi, në pajtim me nenin 65(2) të këtij Kodi”.

Kjo dispozita e fundit thotë: “Dënimi i shqiptuar për tentativë, për ndihmë dhe për bashkim kriminal nuk duhet të jetë më i lartë se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për veprën penale (...).” Tani dispozita e ngjashme (Neni 28, par. 3, KPK) vetëm thotë në fund “dënohet si të kishte kryer veprën penale, megjithatë dënimi mund të zbutet.”.

Vepra penale e shantazhimit “dënohet me dënim burgu prej tre muaj deri në pesë vjet”, Neni 268, par. 1, KPPK. (me që nuk konsiderohet se kodi i ri penal në fuqi nga data 1 janar 2013 do të ishte më i favorshëm), që çon në përfundimin, se sipas dispozitës nga neni 65, par. 2, KPPK, tentativa është e dënueshme nga tre muaj deri në (5 vjet apo 60 muaj:4 = 45 muaj apo 3 vjet e 9 muaj) 3 vjet e 9 muaj.

Duke marrë në konsideratë kriteret e përgjithshme për caktimin e dënimit, sipas neneve 38 dhe 64, par. 1, KPPK, gjykata duhet të marrë në konsideratë jo vetëm rrethanat lehtësuese dhe rënduese por edhe , në veçanti, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet e kryerjes së veprimit, intensitetin e rrezikut apo lëndimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer veprimi, dhe këto kritere duhet vlerësuar duke marrë parasysh faktet e vërtetuara.

Nga faktet e vërtetuar rezulton se organizuesi kryesor ishte i pandehuri M.H., që mbante vendimin e tij gjatë kohës kur bënte aranzhimet, përkatësisht marrjes së mjetit të duhur për incizim, insistonte me të pandehurin tjetër duke ofruar një punë, motivet megjithëse ishte palë e tretë (nuk ishte palë në marrëveshjen e tokës), sasia e përfshirë në shantazh (2 hektarë), se ishte kreditor i dajës së tij (i cili ishte njeri i pasur dhe se duhej mbështetur në dajën e tij që herët a vonë , në një mënyrë apo tjetër, borxhi duhej paguar), dhe se ai ishte mbajtës I

familjes që përbëhej nga bashkëshortja e tij dhe 4 fëmijë, është vendosur se dënimi adekuat për të pandehurin B. është 1 vjet e 6 muaj burgim.

Nga faktet e vërtetuara, sa I përket të pandehurës A.M., rezulton se ajo nuk ishte organizuesja kryesore, se ajo mbante vendimin e saj gjatë kohës, përkatësisht kishte insistuar me palën e dëmtuar F.in që të kishin takim (me sms dhe thirrje telefonike), por gjithashtu ishte pajtuar me premtimin e marrjes së vendit të punës, se gjendja familjare e saj nuk dihet, është vendosur se dënimi adekuat për të pandehurën A.M. është 6 muaj burgim.

Sipas kriterëve nga nenet 42 deri 44 KPPK., në veçanti nenit 43, par. 2, koha e burgimit do të suspendohet për periudhën prej 2 vjetësh për të pandehurin B.dhe për periudhën prej 1 viti për të pandehurën A.M., që do të thotë se dënimi me burg nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore prej 2 vjet përkatësisht 1 vjet.

Konfiskimi i gjëseneve: Nuk ka gjësene të evidentuara në aktakuzë për t'u konfiskuar.

Nuk ka kërkesë pasurore: megjithatë palës së dëmtuar duhet t'i bëhet me dije mundësia e parashtrimit të padisë civile (përveç rasteve në zhvillim e sipër, nëse ajo vendos për këtë).

Shpenzimet e procedurës (siç përcaktohet me nenin 450 KPP.) duhet të paguhen nga të pandehurit Sh.B. dhe A.M..

Sipas nenit 450, par. 2.6, shumat e caktuara janë nga 100 euro për secilin të pandehur të cekur në paragrafin paraprak.

Gjykata nuk sheh të nevojshme që, sipas detyrës zyrtare, ta shpall këtë aktgjykim përmes shtypit, radios apo televizionit, Neni 365, par. 1.1.6, KPPK, për të mbrojtur vlerat e Drejtësisë dhe Interesit Publik.

Deri në përfundimit e plotë të procedurës, çdo ndryshim I adresës së ndonjërit pjesëmarrës duhet të lajmërohet në gjykatë, sipas nenit 368, par. 3, KPPK.

Vazhdo në përputhje me procedurën siç përcaktohet në nenet 474, par. 3, dhe 369, par. 3 dhe 4, KPPK.

Mjeti Juridik: Sipas neneve 374, par. 1.1, dhe 380, par. 1, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së një kopje të tij.

Procesmbajtësja e caktuar ne seancën e këshillimit dhe votimit:

Carla Gomes

Përpiluar në Gj. Angleze (Gjuhë e autorizuar), në Prishtinë, më 8 dhjetor 2014,

Kryetari i Trupit Gjykses

Jorge Martins-Ribeiro

Procesmbajtësi

Carla Gomes

MJETE JURIDIKE:-

Personat e autorizuar mund ta bëjnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi në Gjykata e Apelit nëpërmjet Gjykatës Themelore të Prishtinës, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e marrjes së kopjes së këtij aktgjykimi, sipas nenit 380, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.